Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Kreshnik Spahiu	**04.07.2023**	**10.07.2023**	**2023/0454**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.07.2023, OE "BAK - ING" SH.P.K - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me numër 2023/0454, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE N.P. " Bosch " - Mitrovicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi, montimi i filtrave ne njesit e trajtimit ajrit ne ndertesat Qeveritare", me numër të prokurimit: "214-23-3982-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 70,000.00 €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga AK

- AK ka shkelur nenin 7 te LPP-se,
- AK ka shkelur nenin 59 te LPP-se,
- AK ka shkelur nenin 61 te LPP-se,
- AK ka shkelur nenin 72 te LPP-se,

Pretendimet ankimore

Pretendimi 1. AK ka shkelur nenin 7 te LPP-se pasi qe gjate procesit te vlerësimit nuk i

ka trajtuar te gjithe tenderuesit si te barabarte. Kompanisë qe e ka shpallur fitues nuk ia ka atribuuar mangësitë edhe pse i kishte ne tender in e tije ndërsa neve nuk na ka kërkuar sqarime shtese edhe pse ka pas paqartësi ku sqarimet e tilla ja ka lejuar neni 72 i LPP-se. Konstatimi i vet AK-se se është dashur te na kërkohet sqarime por nuk e kemi bere me qe ne gjoja kemi pasur çmimin me te larte, është i padrejte sepse sipas LPP-se çdo here duhet te vlerësohen dhe trajtohen te gjitha elementet e tenderit gjate procesit te vlerësimit. OE i shpallur fitues ka dorëzuar tender jo-normalisht te ulet sipas nenit 61 te LPP-se dhe AK nuk e ka trajtuar fare ndërsa neve na eliminon me arsyetimin se nuk kemi dorëzuar deklaratën për themelimin e grupit qe sipas dëshmive qe i gjeni tek tenderi jone e vëreni se kjo nuk është e vërtetë. Neve na ka eliminuar edhe për paqartësi ne certifikatën e regjistrimit te anëtarit te grupit pa kërkuar fare sqarime. Ne e kemi dorëzuar deklaratën qe i përmban te gjitha pikat (deklaratat) sipas nenin 11.1 te FDT-se dhe anulimi jone konsiderohet i pabazuar. Pra nga krejt kjo po shihet se AK nuk i ka trajtuar te gjithë tenderuesit si te barabarte dhe me këtë veprim ka shkelur plotësisht nenin 7 te LPP-se.

Pretendimi 2. AK ka shkelur nenin 59 te LPP-se pasi qe gjate vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit ashtu siç ishin përcaktuar paraprakisht. Neni 59.4 i LPP-se shume qarte e përcakton se: Autoriteti kontraktues do te konsideroje një tender si te përgjegjshëm vetëm nëse tenderi ne fjale është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit.

Arsyetimi i AK-se për eliminimin tone gjoja si tenderues i përgjegjshëm duket kështu:

ARSYETIM

Tenderi është i papërgjegjshëm dhe është refuzuar, për arsye se gjatë procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, komisioni i vlerësimit ka konstatuar se:

Nuk është e përgjegjshëm pasi që nuk ka ofertuar siç është kërkuar në dosjen e tenderit tek: Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik pika 11.1

a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për

përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës

b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe

d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

Ky Grup i Operatoreve Ekonomik ka dorëzuar vetëm deklaratën :

a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës, ndërsa nen b, c, dhe d nuk ka dorëzuar fare deklarata siç eshte kërkuar ne dosjen e tenderit.

Gjithashtu anëtari i konzorciumit tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit me Informata mbi biznesin dhe veprimtaritë. Për Operatorin Ekonomik jo rezident ne Kosove, nëse shpërblehet me kontratë, para nënshkrimit te kontratës, është i obliguar qe ta regjistrojnë përfaqësinë e biznesit ne Republikën e Kosovës.
Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a.Certifikatë e regjistrimit të biznesit, me informata dhe veprimtaritë e biznesit (kopje).

Anetari i konzorciumit TEKFIL FILTRE SAN. VE TIC. A.Ş ka dorëzuar nje dokument ne gjuhen turke qe nuk e dimë a eshte Certifikatë e regjistrimit te biznesit apo certifikatë e te hyrave tatimore vjetore, edhe pse ne kemi mundur te kërkojmë informata shtese sipas nenit 59.2 dhe 72.2 te LPP-së , nuk e kemi përdorur këtë mundësi, për arsye se konsiderojmë se edhe pas plotësimit të mundshëm të dokumentacionit nga ju, nuk do të ndryshonte gjendja në renditjen e ofertueseve , pasi qe kemi ofertë te përgjegjshëm me çmimin me te lire se oferta juaj gjithashtu ky tenderues eliminohet për arsyeje e tjera te cekura me lartë.

Arsyetimi i pare është komplet i pabazuar dhe tendencioz qe tregon se AK nuk e ka marruar mundimin as ta lexoj deklaratën për themelimin e grupit te OE. Deklarata për themelimin e grupit te OE e posedon piken a, b dhe c ndërsa si përgjigje ndaj pikës d i kemi dorëzuar te gjitha dëshmitë sipas kërkesave te pikës 6.4 te FDT-se. Ja po e paraqesim ne forme vizuale qe te jemi me korrekt ndaj jush dhe qe te ju sigurojmë se deklarata e konzorciumit i posedon te gjitha.

DECLARATION FOR GROUP ESTABILISHMENT

Të nënshkruhet nga secili anëtarë i grupit / apo konzorciumit që aplikon

For: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME** (hereafter: "contracting authority")

Title of procurement activity: Supply, installation of filters in air handling units in Government buildings

Procurment Number: 214-23-3982-1-2-1

THIS LETTER OF INTENT shows and proves:

Below signed pairs :

1. **BAK-ING SH.P.K.**, registered zoffice in "Hakif Zejnullahu;; Ulpiane Prishtine

and

2. **TEKFİL FİLTRE SAN. ve TİC. A.Ş.**, registered office in Hastane mah. Ayasofya Cad. No:103 Arnavutköy / İSTANBUL

Enter to a coorporation / consortium, for intention of this bid with title: '' **Supply, installation of filters in air handling units in Government buildings** ''procurement no. **214-23-3982-1-2-1**

Pairs confirm that:

- **Pairs declare clearly that as a members of group are together and individuals responsible for the content of the bid's group and if the bid is awarded the contract, for the execution of the contract**
- **The pairs decleare that they are participating as a group and they are not participating in any other group in the same procedure of procurement.**
- **Pairs with this declaration authorize the main partner to act in the name of group, which is:**

Economic Operator Name (leader) **BAK-ING SH.P.K.**

Name and surname (authorized representative) **Baki Shala**

Date/ Signature/Stamp 25.05.2023

Authorized representative will sign the form of the bid and the contract and any other document which is not in anti act with the requests of this folder of bid or LPP??

Other members of the group

Economic Operator Name: **TEKFİL FİLTRE SAN. ve TİC. A.Ş.**

Name and surname: **Tümay ÜLGEN**

Date/ Signature/Stamp 25.05.2023

TEKFİL FİLTRE Sanayi ve Tic. A.Ş. Ayasofya Cad. No:103 Hastane/İST. Tel: 0212 771 56 16-17-18 Beyoğlu/Galata V.D.: 8340751479

Pra po shihet hapur se deklarata e jone i posedon piken a, b dhe c te kërkesës nen piken 11 .1 te FDT-se. Arsyetimi tjetër se gjoja certifikata e biznesit e dorëzuar nga anëtari i dyte i grupit nuk është e qarte dhe nuk posedon aktivitetet, tregon se AK nuk e ka shfrytëzuar nenit 72 te LPP-se për sqarim te kësaj paqartësie. Këtë e ka cekur edhe vet AK tek arsyetimi për anulim, andaj konsiderojmë qe AK është dashur te kërkoj gjithsesi sqarime shtese. Po ashtu aplikimi i nenit 13 te LPP-se tek refuzimi i kërkesës për rishqyrtim është i pa lejuar dhe ne realitet AK nuk ka pasur te drejte ta aplikoj pa kërkuar sqarime shtese. Këtë çështje e ka

interpretuar edhe KRPP ne një nder kërkesat tona për interpretim ku nder te tjera ka thëne se: Ndërsa për cilindo dokument tjetër te kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 te LPP-se, ne përputhje me nenin 72 le LPP-se mund le kërkohet nga OE qe te dorëzojë një përkthim zyrtar te te njëjtit dokument.

Pra nga kjo po shihet se AK detyrimisht është dashur qe te kërkoj sqarime shtese sepse këtë e thotë edhe *KRPP* por edhe neni 72 i LPP-se. Përveç kësaj duam te sqarojmë se Certifikata i posedon te gjitha te dhënat ku pas kërkesës për sqarim do te bindej edhe AK se ajo është komplet ne rregull vetëm se nuk e ka kuptuar gjuhen ne te cilën është certifikata. Pra veprimi AK për eliminimin tone bie ne kundërshtim te plote me nenin 59.4 dhe 72 te LPP-se. AK ka shkelur nenin 59 te LPP-se edhe me rastin e vlerësimit te tenderit qe e ka shpallur fitues pasi qe nuk e ka trajtuar atë fare sipas nenit 61 te LPP-se dhe as sipas nenit 41 te RRPP-001/2022. OE N.P. BOSH ka ofertuar me 9mim shume te ulet ne krahasim me tenderuesit tjerë si dhe ne krahasim me vlerën e parashikuar nga AK ku sipas nenit 61 te LPP-se duhet konsiderohet tender jo-normalisht i ulet me qe janë plotësuar te tre pikat e nenit 41.3 te RRPP 00 1/2022. Ja dëshmitë:

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e Ofertave (me peshim) €
1.	N.P." Bosch ", Artim Jashari, 18, -, MITROVICË	34,333.49
2.	" EJONA " SH.P.K., Zahaq, 30000, Peja	58,969.96
3.	InterAdria L.L.C., ALI KELMENDI NR.28, -, PRISHTINË	57,452.37
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik BAK - ING SH.P.K.; TEKFIL FILTRE SAN. VE TIC. A.Ş., Hakif Zejnullahu, 10000, Prishtine	54,830.93

41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme :

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Pra po shihet se te tre kushtet e nenit 41.3 te RRPP 001/2022 janë plotësuar dhe tenderuesi do duhej te sqarohej sipas neni 41.3 te RRPP-001/2023 ose te konsiderohej i papërgjegjshëm. Edhe referencat dhe kontratat e këtij OE duken te jene te dyshimta ku asnjëra nga to nuk e posedon datën e sakte te realizimit te furnizimit. Sipas rregullave mbi dëshmitë për projektet e realizuara, data e përfundimit te projektit është një nder te dhënat e domosdoshme qe duhet ta përmbaj një reference. Atë përpos tjerash duken te jene jo reale sepse te gjitha janë me blerës privat për te cilat do duhej qe AK te beje një verifikim mbi transaksionin dhe faturat e dorëzuara ne ATK. Këtë realisht duhet ta beje edhe eksperti shqyrtues sepse nga pamja e tyre lejnë përshtypjen te jene referenca fiktive. Nga krejt kjo qe thamë shihet se gjate procesit te vlerësimit AK nuk e ka respektuar si duhet nenin 59 te LPP-se.

AK me rastin e shqyrtimit te kërkesës për rishqyrtim ka shkelur edhe nenin l08/ A te LPP-se sepse kërkesën tone e ka trajtuar pjesërisht te bazuar ndërsa ne anën tjetër vendimin e njëjtë e

ka Jene ne fuqi. Përpos kësaj AK nuk ka dhënë informata te sakta me rastin e refuzimit te pretendimit lidhur me shkeljen e nenit 61 te LPP-se pasi qe vet deklaron se AK nuk ka te drejt qe automatikisht ta eliminoj një tenderues për tenderin e tije jo-normalisht te ulet pa aplikuar procesin inter partes me operatorin ekonomik ndërsa ne realitet këtë nuk e ka bere fare. Ne e kemi pyetur AK-ne pas refuzimit te kërkesës për rishqyrtim se mos eventualisht i kane kërkuar OE ne fjale sqarim lidhur me tenderin jo-normalisht te ulet siç e parasheh neni 61 i LPP-se dhe neni 43 i RRPP-001/2022 dhe i kemi kërkuar te na i dërgojnë dëshmitë e tilla por AK ka deklaruar përmes telefonit se nuk kane kërkuar fare sqarime shtese nga ky OE dhe nuk kane se çfarë dëshmie te na japin. Edhe kur kemi kërkuar qasje ne dokumentet e tenderit para se te parashtrojmë kërkese për rishqyrtim, e kemi vërejtur se kjo nuk ka ndodhur.

Pretendimi 3. AK ka shkelur nenin 61 te LPP-se dhe nenin 41 te RPP-001 /2022 kur e ka shpallur fitues OE N.P. BOSCH pasi qe mendojmë se ky i fundit ka dorëzuar një tender qe sipas këtyre dispozitave duket te jete tender jo-normalisht i ulet. Këtë e themi sepse ne baze te krahasimit te bere me çmimet konkurruese dhe vlerën e parashikuar te nga AK, de! te jete tender me çmim shumë te ulet.

Vlera mesatare e çmimeve nga te gjithë tenderuesit është vlera 51,396.69€.

Vlera e tenderit te shpallur fites është 34,333.49€ dhe është me shume se 30% me e ulet se vlera mesatare e tenderuesve, është me shume se 10% me e ulet se tenderuesi i dyte si dhe janë dorëzuar se paku tre tender. Kjo tregon se te tre kushtet e nenit 41.3 janë plotësuar qe ky OE te cilësohet si tenderues potencial me çmim jo-normalisht te ulet dhe me qe AK nuk e ka trajtuar site tille, konsiderojmë se AK ka shkelur nenin 61 te LPP-se dhe nenin 41 te RRPP- 001/2022. Ja edhe provat:

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e Ofertave (me peshim) €
1.	N.P." Bosch ", Artim Jashari, 18, -, MITROVICË	34,333.49
2.	" EJONA " SH.P.K., Zahaq, 30000, Peja	58,969.96
3.	InterAdria L.L.C., ALI KELMENDI NR.28, -, PRISHTINË	57,452.37
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik BAK - ING SH.P.K.; TEKFIL FILTRE SAN. VE TIC. A.Ş., Hakif Zejnullahu, 10000, Prishtine	54,830.93

41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme :

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Nr.		LOT		
A	B	C		D
1	**Kushti 1:** është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 4 oferta		**Pranuar 4 oferta**	
2	1		34,333.49	
3	2		58,969.96	
4	3		57,452.37	
5	4		54.830.93	
6	**Total (C2+C3+C4+C5)**		**205,586.75**	
7	**Mesatarja (C6/4)**		**51,396.69**	
8	**Kushti 2**: te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	**pragu 30% (mesatarja /1.3)**	**39,535.92**	ne ketë rast vetëm **oferta 1** përmbushë kushtin e dytë prandaj vazhdohet me kushtin e tretë
9	**Kushti 3**: pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	**pragu 10% (oferta e dyte /1.1)**	**49,846.30**	ne ketë rast **oferta 1** përmbushë edhe kushtin e tretë

Pra edhe nga ky sqarim po shihet se tenderuesi i shpallur fitues ka dorëzuar tender me çmim jo-normalisht te ulet ndërsa mos trajtimi dhe mos cilësimi i këtij tenderuesi site tille nga ana e AK-se konsiderohet me te drejte shkelje e nenit 61 te LPP-se dhe shkelje e nenit 41 te RRPP-001/2022. Forma e sqarimit dhe dëshmitë qe ky OE do duhej te ofronte ne rast kërkesë për sqarim është e treguar tek nenin 41.8 dhe 41.9 i RRPP-001/2022.

Pretendimi 4. AK ka shkelur nenin 72 te LPP-se pasi qe nuk ka kërkuar sqarime nga ne lidhur me paqartësitë qe i ka pasur ne tenderin tone. Neni 72.2 i LPP-se e përcakton qarte qe për sqarim mund te kërkohen lirshëm dokumentet qe lidhen me kërkesat e parashtruara sipas nenit 65 deri 71 te LPP-se andaj mos parashtrimi i kërkesës për sqarim lidhur me certifikatën e biznesit te anëtarit te dyte te konzorciumit konsiderohet plotësisht e kundërligjshme. Edhe KRPP ka dhënë interpretim qe ne rastet e tilla e detyron AK-ne qe te kërkoj versionin e përkthyer te certifikatave dhe dokumenteve te cilat janë dorëzuar sipas nenit 65-71 te LPP-se.

Kjo pra tregon qarte se AK ka shkelur nenin 72 te LPP-se me qe nuk ka kërkuar sqarime për kërkesat dhe dokumentet qe janë te lejueshme dhe duhet te sqarohen.

Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga ato qe thamë me larte, kërkojmë nga OSHP qe te marr:

VENDIM

APROHOHET si e bazuar ankesa e Grupit te OE "BAK - ING SH.P.K. & TEKFIL FILTRE SAN. ve TIC. A.S." lidhur me tenderin "Furnizimi, montimi i filtrave ne njësite e trajtimit ajrit ne ndërtesat Qeveritare" i iniciuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - Ministria e Punëve të Brendshme dhe lënda te kthehet ne ri-vlerësim.

Ri-vlerësimi te behet plotësisht duke u bazuar ne dispozitat ligjore te LPP-se, kërkesat e dosjes se tenderit dhe specifikimet teknike te Aneksit 1, e qe realisht me pas do duhej qe FITUES te shpallej Grupit te OE "BAK - ING SH.P.K. & TEKFIL FILTRE SAN. ve TIC. A.S.".

KRITERET PËR VLERËSIM

N/A

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i vlerësimit ne baze te ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te ofertave, ka konstatuar se për tenderin: "Furnizimi, montimi i filtrave ne njësit e trajtimit ajrit ne ndërtesat qeveritare janë pranuar katër (4) oferta oferta dhe ne baze të dokumentacionit të prezantuar në tender tri (3) oferta janë të përgjegjshme, duke u bazuar ne vlerësimin nga ana e përshtatshmërisë administrative, tekniko profesionale si dhe aspektin e specifikimeve teknike te kërkuar ne Aneksin 1, dhe një (1) ofertë është e papërgjegjshme.

Duke e marrë parasysh se kriter vlerësimit ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët dhe pas korrigjimit te gabimeve aritmetikore komisioni vlerësues u përcaktua qe te pranohet oferta e N.P." Bosch", Artim Jashari, 18, -, Mitrovicë, në shumë prej: 34,338.60 euro dhe ne si komision i vlerësimit i propozojmë zyrtarit përgjegjës të prokurimit ta shpërblej me kontratë.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ka dorëzuar ofertë në këtë aktivitet të prokurimit, rrjedhimisht ka interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" BAK - ING " SH.P.K.**

Sqarim hyrës - Fillimisht sqarojmë se OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 19.06.2023 me pretendime të njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë. AK me datë 23.06.2023 ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të OE ankues dhe në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë. Andaj, në vijim janë dhënë përgjigjet numër 1 dhe 2 për pretendimet që lidhen me arsyet e eliminimit të OE ankues dhe përgjigja numër 3 që ka të bëjë me pretendimin ankimor për ofertën e OE të rekomanduar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1 - OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, në lidhje me arsyetimin e dhënë në vendimin e AK-së të datës 14.06.2023 ku AK konstaton se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesën 11.1 të dosjes së tenderit. AK në vendimin e datë 14.06.2023, në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar ka dhënë arsyetimin për eliminimin e OE ankues si vijon:

- *Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga secili anëtar, e cila konfirmon pjesëmarrjen e tyre ne grup dhe se ata nuk marrin pjese ne mënyrë individuale dhe/apo ne ndonjë grup tjetër pjesëmarrës ne procedurën e njëjtë te prokurimit;*
- *Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga te gjithë anëtarët e grupit e cila autorizon partnerin udhëheqës te veproj ne emër te grupit;*

Në dosjen e tenderit të publikuar nga AK tek Krijimi i grupi të OE-ve, përkatësisht kërkesa 11.1 specifikohet se në rast të ofertim si grup i OE-ve atëherë duhet të dorëzohen:

a. *një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës*
b. *një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup*

tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

c. *një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe*

d. *të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.*

OE ankues ka dorëzuar deklaratë në gjuhën angleze e cilat është e dedikuar për këtë aktivitet të prokurimit dhe përshkruan palët nënshkruese dhe përshkrimin e konfirmimeve për pikat sipas nenit 11.1 të dosjes së tenderit. Dokumenti është i nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesit e dy palëve. Eksperti sqaron se AK nuk ka marrë për bazë deklaratën e dorëzuar nga OE ankues përkundër që në nenin 26.2 të RrPP thuhet se: "*Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokument*". Andaj, arsyetimi i eliminimit lidhur me deklaratat e anëtarëve të grupit të OE-ve është i paqëndrueshëm meqë AK në arsyetim konstaton mungesën e deklaratave në kundërshtim me nenin 26.2 të RrPP-së.

<u>Përgjigje në pretendimin ankimor 2</u> - OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, në lidhje me arsyetimin e dhënë në vendimin e AK-së të datës 14.06.2023 sa i përket certifikatës së regjistrimi të biznesit për anëtarin e grupit "TEKFIL FILTRE SAN. VE TIC. A.S". AK në vendimin e datë 14.06.2023, në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar ka dhënë arsyetimin për eliminimin e OE ankues si vijon: "*Anëtari i konzorciumit "TEKFIL FILTRE SAN. VE TIC" A.S ka dorëzuar një dokument ne gjuhen turke që nuk e dimë a është Certifikatë c regjistrimit te biznesit apo certifikatë e të hyrave tatimore vjetore, edhe pse ne kemi mundur te kërkojmë informata shtese sipas nenit 59.2 dhe 72.2 te LPP-se, nuk e kemi përdorur ketë mundësi, për arsye se konsiderojmë se edhe pas plotësimit te mundshëm te dokumentacionit nga ju, nuk do te ndryshonte gjendja ne renditjen e ofertuesve, pasi qe kemi oferte të përgjegjshëm me çmimin me të lirë se oferta juaj gjithashtu ky tenderues eliminohet për arsyeje tjera te cekura me lartë.*".

Grupi i OE-ve ka dorëzuar dy dokumente si certifikata të regjistrimit; Certifikatën e regjistrimit të biznesit të anëtarit "BAK-ING" Sh.P.K, me numër unik identifikues 810116211, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht Agjencia e Regjistrimit Bizneseve në Kosovë. Gjithashtu ka dorëzuar edhe dokumentin e emërtuar "Certifikata e

Biznesit – Tekfil" e cila është në gjuhën turke. Eksperti sqaron se në lidhje me gjuhën e dokumenteve të dorëzuara, në LPP dhe RrPP nuk përcaktohet zgjidhja për AK-në se si duhet të veprojë në rast se një tenderues paraqet ndonjë nga dokumentet e tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së. Megjithatë, KRPP ka dhënë opinion me datë 22.06.2023, në lidhje me pyetjen "*Si duhet të veprojë AK, në rast se një tenderues paraqet ndonjë dokument të tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së?"*. Në përfundim të opinionit të dhënë nga KRPP thuhet "*..Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument."*. Më tej në nenin 10.1 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik (UPP) në tabelën e shembujve në rastin kur mungon Certifikata e regjistrimit të biznesit, AK udhëzohet se mund të kërkohen informata sqaruese. Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme, AK nuk ka kërkuar sqarime lidhur me certifikatën e regjistrimit të biznesit për anëtarin e grupit, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

<u>Përgjigje në pretendimin ankimor 3</u> - OE ankues pretendon se AK ka rekomanduar shpërblimin me kontratë OE i cili ka ofertuar çmimin jonormalisht të ulët pa aplikuar procedurën e përcaktuar me RrPP. AK në vendimin e datë 14.06.2023, ka rekomanduar shpërblimin me kontratë për OE N.P."Bosch me seli në Mitrovicë, ne vlerë totale të ofertës (pas korrigjimit te llogaritjes aritmetikore) në shumë prej 34,338.60 €. Sipas nenit 41.3 te RrPP, AK kërkon nga OE për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet si vijon:

i. *çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;*
i. *çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;*
i. *janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë*

Më tej në nenin 41.6 thuhet: "*Në rast se një duket të jetë jo normalisht i ulët, AK <u>duhet</u> të kërkoj me shkrim nga OE i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa*

standarde për tenderët jo-normalisht të ulët". Pra, është e domosdoshme aplikimi i procedurës inter partes me OE. Më tej eksperti sqaron se janë plotësuar kriteret e pacaktuara me nenin 41.3 të RrPP për tenderuesin jonormalisht të ulët për OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa sipas shkresave të lëndës AK nuk ka zbatuar procedurën inter partes me OE të rekomanduar për kontratë, që do të duhej ta bëjë sipas dispozitave të sipërpërmendura. Andaj, duke u bazuar në sqarimet e sipërpërmendura, eksperti sqaron se pretendimi ankimor është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" BAK - ING " SH.P.K.**

Kreshnik Spahiu